



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF
GJAKOVA**



Zyra e Prokurimit
Dt.13.11.2024

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 37 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) në lidhje me kontratën me numër të prokurimit: 632-23-9550-2-2-5, numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-19619, për shkak të mos-përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktorit: " SYRI " SH.P.K., rr."Sadik Pozhegu", Gjakovë, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësisë ligjore, më dt. 13.11.2024, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM
Për ndërprerjen e Kontratës

1. Për shkak të dështimit për të përmbushur obligimet kontraktuale, që parqet element thelbësorë të kontratës, Kontrata me numër të prokurimit: 632-23-9550-2-2-5, numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-19619, e datës 02.10.2023, për realizimin e kontratës: 'të Komunës së Gjakovës dhe Kryesit të shërbimeve " SYRI " SH.P.K., rr."Sadik Pozhegu", Gjakovë, NDËRPRITET .
2. Për shkak se Kontraktuesi: " SYRI " SH.P.K., rr."Sadik Pozhegu", Gjakovë, është përgjegjës për mos përmbushje të obligimeve që dalin nga kontrata, obligime këto që janë kusht esenciale dhe themelor i kontratës, NDËRPRITEN së vepruari të gjitha raportet dhe marrëdhëniet Autoritet Kontraktues – Kontraktuesi, të rregulluara me Kontratën 632-23-9550-2-2-5, numër të brendshëm 632-23-145-225 dhe me nr. të protokollit 01nr.410/04-19619, të datës 02.10.2023, për çka Autoriteti Kontraktues, do të kërkoj konfiskimin e sigurimit të ekzekutimit për kompensimin e dëmit të shkaktuar.

3. Me qëllim të kompensimit të dëmeve të shkaktuara nga veprimet e pajustificuara të Kontraktuesit, Autoriteti Kontraktues do të ndërmarrë veprimet e nevojshme procedurale – ligjore në pajtim me Kushtet e Kontratës.
4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për: “Përcjellja mediatike e aktiviteteve Komunale”, të dt.02.10.2023, ne mes të Komunës së Gjakovës dhe Kryesit të shërbimeve " SYRI " SH.P.K., rr.”Sadik Pozhegu, Gjakovë, për kryerjen e shërbimeve të kontraktuara sipas Kontratës.

Me qëllim të menaxhimit dhe zbatimit në kohë dhe në mënyrë cilësore të kontratës, Zyrtaari Kryesorë Administrativ i Autoritetit Kontraktues – Ardian Gjini, Kryetari i Komunës, me Vendimin e tij 01nr. 112/01-19599, dt.02.10.2023, ka emëruar Menaxherin e Kontratës dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejte të Menaxherit të Kontratës, me të drejta dhe obligimet sikurse janë përcaktuar në Vendim.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësisve të tija, përmes kërkesës dërguar në rrugë elektronike në Zyrën e Prokurimit me datë 06.11.2024, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së Prokurimit ndërprerjen e Kontratës për mos realizim të kontratës konform kushteve të kontratës.

Me datë 06.11.2024, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, në përputhje me nenin 9 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) ka dorëzuar “Njoftimin për shkëputje të kontratës” të OE: " SYRI " SH.P.K., rr.”Sadik Pozhegu, Gjakovë.

Duke qenë se Kontraktuesi: përmes emailit , ka njoftuar që deri në rregullimin e problemeve teknike, mbledhja e Kuvendit të Komunës së Gjakovës do të transmetohet në webfaqen tonë zyrtare, por jo edhe në kanalin televiziv, për shkak të problemeve teknike por edhe financiare, duke mos u përgjigjur pozitivisht në kërkesat e AK Komuna e Gjakovës.

Për të kryer të gjitha shërbimet sipas kërkesave teknike të saktësuara në Dosjen e Tenderit , këto veprime të Kontraktuesit, nga ana e AK Komuna e Gjakovës, janë vlerësuar të paarsyeshme, prandaj kontrata ndërpritet duke u bazuar në nenin 9, paragrafi 9.1, pika a dhe b, të Pjesa II e Kontratës – Kushtet e Përgjithshme.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, AK Komuna e Gjakovës, përfundimisht ka vlerësuar se Kontraktuesi " SYRI " SH.P.K., rr.”Sadik Pozhegu, Gjakovë, duke mos zbatuar kërkesat e AK Komuna e Gjakovës, për zbatim të plotë të kontratës, është përgjegjës për shkak të dështimit të tij për të kryer shërbimet e kontraktuara konform kërkesave dhe Specifikave Teknike të shërbimit.

Andaj, për arsye të sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës



Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Punët e Përgjithshme Administrative;
Drejtorisë për Buxhet dhe financa
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.